



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

UDHËZIM

NR. 11 , datë 16 /05/2019

Nr. 12275 prot

dt. 16 /05/2019

“Për disa shtesa në Udhëzimin Nr.01, datë 14. 01. 2011 “Mbi procedurën e përpunimit të deklaratës doganore (DAV) në Sistemin Asycuda World”

Në zbatim të nenit 17 dhe 150 të Ligjit Nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë” nenit 303 të VKM nr.651 datë 10.11.2017/174 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, mbi procedurën e përpunimit të deklaratës doganore (DAV) në Sistemin Asycuda World”

UDHËZOJ:

Ndryshimet në Udhëzimin Nr.01, datë 14.01.2011 “Mbi procedurën e përpunimit të deklaratës doganore (DAV) në Sistemin Asycuda World” në pikat:

Pika 31 ndryshon;

Përgjegjësi i zyrës/turnit kryen veprimin “print release order” në sistemin asycuda world i cili presupozon dhe vulosjen e deklaratës doganore me nënshkrim elektronik. Pas plotësimit të urdhër çlirimit deklaruesit nga ana e sistemit i dërgohet një email duke e njoftuar se duhet të printohet deklarata doganore në format PDF. Deklarata doganore (DAV) do të jetë e vulosur me vulë elektronike sipas formatit/modelit të miratuar me shkresën e DPD-se nr.10795 datë 30.04.2019.

Pika 32 ndryshon;

Dalja e mallrave nga zyra doganore kushtëzohet me printimin e deklaratës doganore në formatin PDF me vulë elektronike sipas formatit/modelit të miratuar me shkresën e DPD-se nr.10795 datë 30.04.2019.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arlind Gjokuta

